

KLSH DHE PARTNERËT NDËRKOMBËTAR TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

nga Kozma KONDAKÇIU¹- Drejtor Drejtorie,
Botuar në gazetën “Telegraf”, më 04 maj 2015.



Në datat 24-25 mars 2015 në Zyrën Federale të Auditimit të Zvicrës u mbajt takimi i grupit të punës mbi Vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit (ITSA) dhe Vetëvlerësimin të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (ITASA), projekt i kryesuar nga Zyra e Auditimit të Zvicrës.

Takimi u zhvillua me moton e:

- Nxitjes së shkëmbimit të ndërsjellët të përvojave ndërmjet SAI-ve;
- Inkurajimit të zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta të fushës;
- Zbatimin e iniciativave të Komitetit të Përhershëm të INTOSAI-t për Auditimin e IT.

Në takim merrnin pjesë përfaqësues nga institucionet e Auditimit të: Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Estonisë, Francës, Hungarisë, Lituaniës, Moldavisë, Holandës, Polonisë, Ruisë, Turqisë dhe Zvicrës. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit morën pjesë z. Kozma Kondakçiu, Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe z. Benard Haka, auditues.

Gjatë takimit dy ditë u trajtuan:

1. Ndjekja e rezultateve dhe veprimeve të lëna në simpoziumin shkencor mbi IT zhvilluar në Potsdam të Gjermanisë në lidhje me ITSA dhe ITASA (Mars 2014);
2. Zhvillimet e metodologjisë së vetëvlerësimit dhe tendenca për ta kthyer atë në i-vetëvlerësim , ku veçojmë paraqitjen e përdorimit të mjeteve web online (në kryerjen e pyetësorëve të këtij procesi) nga SAI i Zvicrës si dhe paraqitja e mjeteve shumë gjuhësh të zhvilluara në Excel për përfitimin e shpejtë të rezultateve të vetëvlerësimit (në më pak se ½ orë) zhvilluar nga z.Ferenc Borsos nga SAI i Hungarisë;
3. Shkëmbimin e eksperiencave nëpërmjet prezantimit të rezultateve të vetëvlerësimeve të zhvilluara në vitet 2014-2015 në Sllovaki, Belgjikë, Lituani, Estoni e Shqipëri.

Nga ana e përfaqësuesve të KLSH u krye prezantimi i ITSA-s së kryer në periudhën 29 shtator - 1 tetor 2014 me moderim nga z. Massimo Magnini dhe z. Alberto Paridi dhe zëvendës moderator z. Kozma Kondakçiu.

Në prezantim krahas njohjes së të pranishmeve me rezultatet e këtij vetëvlerësimi nga prezantuesi z. Kozma Kondakçiu u bë një njohje e të pranishmëve me të dhëna mbi Shqipërinë dhe Institucionin e saj Suprem të Auditimit.

Me interes dhe vlerësim u ndoq historiku i zhvillimit të IT si dhe përpjekjet dhe investimet e kryera në teknologjinë e informacionit në vitet 2011-2014.

Pas prezantimit të rezultateve të vetëvlerësimit fokusi ishte ndjekja e zbatimit të detyrave të dala nga vetëvlerësimi i IT ku u veçua:

- ndryshimet strukturore;
- përmirësimet ligjore;
- përgatitja e akteve rregullatorë;
- përgatitja e dokumenteve standarde dhe template;
- përpjekjet për informatizimin e proceseve të punës në institucion.

Zhvillimi i vetëvlerësim të integritetit si pjesë së zhvillimit të analizës vjetore 2014 duke zbatuar mjetet e vlerësimit të ngjashme me ato të propozuara u ndoq me interes dhe pyetje nga të pranishmit.

Në vazhdim të takimit në ditën e dytë u paraqitën rezultatet e auditimeve paralele 2014-2015 për:

- Pasaportat biometrike;

- Mbrojtjes së të dhënave me pjesëmarrjen e SAI-ve të: Moldovisë, Maltës, Lituanisë, Estonisë, Hungarisë, Belgjikës. Drafti i programit të auditimit do të ndahet me pjesëmarrësit e takimit në fund të muajit mars.

Në përfundim pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me ide e projekte të ardhshme të grupit të IT.

Gjatë qëndrimit u zhvilluan takime e biseda të veçanta me përfaqësues të SAI-ve pjesëmarrës, dhe u vendosën pika kontakti me ta për një bashkëpunim të mëtejshëm.

Vlen të përmendet kontakti me përfaqësuesin e SAI të Holandës z. Henk Van Der Geest i cili është pjesë e trajnimit të IT Audit në ZAP-in e Kosovës në kuadër të projektit të binjakëzimit, që kjo e fundit po përfiton nga BE.

Për këtë u bisedua për mundësinë e kryqëzimit të përfitimeve dypalëshe nga trajnimet e përfituara nga binjakëzimi i Shqipërisë me SAI-n Polak dhe Kosovës me Gjykatën e Llogarive të Holandës.



Në fund të takimit u miratuan:

- Plani i Auditimeve paralele në IT Audit;
- Programi për kryerjen e ITSA dhe ITASA në dy vitet e ardhshme ku një vend ju rezervua edhe Shqipërisë për përfitimin nga këto procese.

Përgatitja e takimit të Varshavës 1-2 korrik 2015 të ITWG, që do të pasojë takimin e INTOSAI të 29 qershor-1 korrik 2015.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Kozma KONDAKÇIU për periudhën janar-qershor 2015:*

- *Sistemet virtuale, aplikimi dhe auditimi i tyre.*
(Botuar në gazetën “Telegraf” , më 17 qershor 2015.)